



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:075132

Datë: 29.07.2019

Numri i dokumentit: 00433062

P.nr.75/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ylberza Gllogjani, në çështjen penale kundër të akuzuarit Y. H. nga Peja, për vepër penale **“rrezikim i trafikut publik”**, parashikuar nga neni 378 par 8 lidhur me par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, PP/II-nr. 342/19 dt.27.03.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datë 12.06.2019, në prezencë të Prokurores të shtetit Ardiana Veseli dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

Y. H. i lindur me ... në Pejë, i biri i B. dhe i nënës S. e lindur T., student, i pa martuar, automekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. ..., me nr. tel ..., Shqiptar, shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datën 17.09.2018 rreth orës 22.15, minuta, ne rrugën "..." në Pejë, pikërisht te kafiteria "2...", nga pakujdesia ka shkel nenin 53 të Ligjit mbi Komunikacionin Rrugor të Kosovës, në atë mënyrë që i pandehuri gjersa po qarkullonte me motoçikletën e tij te tipit Piaggio M 28, me targa ..., kur arrin në vendin e lartcekur, duke mos i kushtuar rendësi këmbësoreve, te cilët ishte duke kaluar rrugën, nga krahu i djathtë në të majtë shikuar drejtimin e lëvizjes së motoçikletës, me ti vërejtur këmbësoret, provon qe ti shmanget goditjes së tyre, por pa suksese, ashtu që, me gomën e parë te motoçikletës, i godet të dy këmbësoret, të dëmtuarit A. dhe S. G., te cilët i përplas për tokë, e si pasojë e aksidentit të dëmtuarit A.G. ka pësuar lëndime te renda trupore, me pasoja te përkohshme në shëndet, ndërsa e dëmtuara S. G. ka pësuar lëndime te lehta trupore me pasoja te përkohshme, e po ashtu edhe i pandehuri ka pësuar lëndime te lehta trupore, me pasoja të përkohshme ne shëndet,

- me çka ka kryer vepër penale, “**rrezikim i trafikut publik**”, parashikuar nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 1 të KPRK-se.

-

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7, 8 par 1, 9, 10 par 1, 17 par 1, 23 par 1 dhe 2, 41,42 par 1 nën par 1.1,43 par.1 pika 1.2 apo 1.3, 45,46, 47, 67 par.1, 73,74,76 dhe 378 par 8 lidhur me par 1 të KPRK-së, dhe nenin 245, 246, 248 par 1 dhe 4, 359, 360,361,365,366,453 par 4, të KPPK-së, të akuzuarit e:

G J Y K O N

1.- I cakton dënim burgimi prej 6(gjashtë) muaj.

2.-Me pëlqimin-kërkesën me shkrimë të menjëhershme të paraqitur nga ana e të akuzuarit, pas shpalljes së aktgjykimit, e bazua në nenin 47 të KPRK-ës, dënimi me burgim, ju zëvendësua me gjobë në shumë prej 700(shtatëqind) euro.

3.-Dënimin me gjobë ka për tu ekzekutuar, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

4-Nëse i akuzuari nuk e ekzekuton dënimin me gjobë si në piken 2, të dispozitivit, dështon apo refuzon për ta përmbushur, atëherë ky dënim, ka për tu zëvendësuar me dënime me burg duke llogaritur për çdo ditë qëndrimi nga 20(njëzet) euro, gjersa të arrihet shuma e gjobës 700 euro.

5-Detyrohet i akuzuari që, në emër të shpenzimeve të procedurës penale t’ia paguaj gjykatës shumën prej 20€(njëzet euro), për paushall gjyqësor shumën prej 15€(pesëmbëdhjetë euro), ndërsa, në emër të kompensimit të viktimave, shumën prej 30€, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

6-Të dëmtuarit, A. dhe S.e G. nga Peja, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Ndaj të pandehurit **Y. H.** në kuptim të nenit 67 par 1, të KPRK-së, i shqiptohet

DËNIMI PLOTËSUES – Ndalimi i drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej 1 viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i përgjithshëm, ka ngrit aktakuzën **PP.II.nr.2564/18, të dt. 05.02.2019**, ndaj te pandehurit Y. H., nga Peja, për shkak të veprës penale “**rrezikim i trafikut publik**”, parashikuar nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me date 12.06.2019, ne prezencë te prokurorit te shtetit, dhe te pandehurit Y. H., i cili u njoftua me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij dhe pas kësaj prokurori lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit te aktakuzës nga ana e prokurorit, i pandehuri, u deklarua se e pranon fajësinë, për veprën penale, me të cilën akuzohet sipas aktakuzës.

Meqenëse i akuzuari Y. H., që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në tërësi e ka pranuar fajësinë, për veprën penale për të cilën akuzohet, Prokurori i Shtetit, është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata është bindur se i akuzuari i ka kuptuar pasojat dhe privilegjet e pranimit te fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pa presion nga askush, e pas këshillimeve të mjaftueshme që i akuzuari, pati paraprakisht nga ana e Gjykatës .

Pranimi i fajësisë, është i bazuar në provat në shkresat e lëndës, procesverbali mbi vend shikimin e aksidentit, me nr. DR-3004-685-2018, dt. 18.11.2018, raporti i aksidentit, dt. 17.09.2018, deklarata e të pandehurit, e dhënë në polici dhe prokurori, deklarata e të dëmtuarve të dhënë në polici dhe prokurori, fletë kontrolli mjekësor, fotografit nga vendi i ngjarjes, ekspertiza e aksidentit të komunikacionit, e punuar për rastin nga eksperti Ing. i dipl. Sami Bardheci, dt. 09.01.2019, akt ekspertiza mjeko-ligjore, e punuar nga Dr. N. U., si dhe shkresat tjera të lëndës. Aktakuza, nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore. Për këtë Gjykata gjen se, janë plotësuar kërkesat e parapara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, ashtu që në kuptim të nenit 326 par. 4 të KPPK-së, fare nuk ka procedua provat dhe e ka pranua pranimin fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale **“rrezikim i trafikut publik”**, parashikuar nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Në fakt, Gjykata ka vërtetua se i akuzuari Y. H., ditën, kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, e ka kryer veprën penale **“rrezikim i trafikut publik”**, nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Për këtë Gjykata gjen se, i njëjti është i fajshëm dhe për këtë e shpallë fajtor dhe penalisht përgjegjës.

Para se të vendoset mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka marre për baze te gjitha rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese, të cilat kishin për te ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, të cilat i kanë paraqitë palët në procedurë. Rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata gjeti se i njëjti ka vozitur pa patentë, pa regjistrim te motoçikletës, ikja e tij nga vendi i ngjarjes. Si rrethana lehtësuese për të akuzuarit, janë marr sjellja e tyre tejet korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësorë, faktin se asnjëherë më parë nuk kanë qenë të gjykuar për ndonjë veprë penale ,faktin faktin se i akuzuari qe ne fillim te shqyrtimit gjyqësorë ne tersi e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar. Janë pajtua me të dëmtuarit.

Duke i pasur parasysh edhe këto rrethana gjykata duke aplikuar zbutjen e dënimit brenda kufijve të përcaktuar ligjorë paraparë me nenin 76 par.1 pika 3,të KPK-së , te akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoj me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muj burgimi, duke ja lënë mundësin qe, ky dënim në kuptim te nenit 47 par.1 të KPRK-ës, mund të zëvendësohet me gjobë në shumë prej 700 euro më kërkesën –pëlqimin e të akuzuarit.

I akuzuari, i pranishëm me rastin e shpalljes së aktgjykimit burimor, ditën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 12.06.2019, menjëherë pas shpalljes ka parashtruar kërkesë me shkrim, të cilin edhe e ka nënshkruar që ti zëvendësohet dënimi me burg, në dënim me gjobë, si në pjesën urdhëruese të aktgjykimit, të formular pas kërkesës së të pandehurit, ku dënimin me burg të shqiptuar (gjykuar) si në pikën 1 të dispozitivit të aktgjykimit ja zëvendëson në shumën tani prej 700 euro, me detyrim, për ta paguar në afatin e caktuar prej 30 ditëve, pasi që aktgjykimi të merre formën e prerë, në të kundërtën dënimi me gjobë, ka për tu shndërruar në dënim burgimi nëse nuk e paguan, apo dështon ta paguaj duke llogaritur 20 euro, për një ditë qëndrimi në burg.

Duke i vlerësua kështu të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato renduese, gjykata ka ardhë në përfundim se dënimi i shqiptuar është në proporcion me shkallen e përgjegjësisë penale të të akzuarit, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer dhe me intensitetin e pasojës së shkaktuar, e duke qenë të sigurt se dënimi i shqiptuar është i baras-peshuar dhe do të jetë në funksion të arritjes së qëllimit të dënimit, si preventiv për pengimin e të akzuarve, por edhe të personave tjerë, nga kryerja e veprave penale dhe se fundi, një dënim i tillë dot e ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e të akzuarve.

Vendimi që të akzuarit të ja kompensoj gjykatës shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, e mori komfort nën par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPRK-së, **duke i** përcaktuar shpenzimet procedurale gjyqësore në shumë prej 20 euro, ndërsa paushallin gjyqësor në shumë prej 15 euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj, me bindje se të akzuarit i kanë kushtet për përmbarim.

Vendimin për kompensim të viktimave të krimit, në shumën prej 30€, gjykata e mori në përputhje me nenin 39 par.1,2,3 pika3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara që, kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest civil, u morr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi për dënimin plotësues, gjykata e mori bazu në kërkesën e prokurorit e në përputhje me nenin 67 par. 1 të KPRK-ës, përmes të secilit të akzuarit i ndalohet drejtimi i automjetit në kohëzgjatje prej një viti, pasi që aktgjykimi të bëhet i plotë fuqishëm.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHË
P.nr.75/19 më datë 05.07.2019.

Sekretarja Juridike
Ylberza Glllogjani

Gj y q t a r i,
Dr.sc. Murat Hulaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.